



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE

Nr. 446 Prot.

Tiranë, më 23.02.2024

Lënda: Dërgohet për miratim plani i punës për Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë, për vitin 2024.

MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
TIRANË

Në mbështetje të pikës 6, gërma b, të VKM nr. 325 datë 18.05.2022 "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë", bashkëlidhur Ju përcjellim për miratim Planin e Punës të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, për vitin 2024.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Petrit Rama





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE

INFORMACION

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ushtron veprimtarinë në mbështetje të Ligjit Nr. 126/2020, datë 15.10.2020 "Për Metrologjinë".

Ky ligj rregullon sistemin kombëtar të Metrologjisë në Shqipëri dhe kërkesat për të kryer veprimtaritë në metrologjinë shkencore, industriale dhe atë ligjore.

Dispozitat e këtij ligji do të zbatohen në ato instrumente matëse, që përdoren për matje në transaksionet tregtare dhe zyrtare, kujdesin shëndetësor, mbrojtjen e mjedisit, rendin publik, sigurinë dhe mbrojtjen e konsumatorit.

Sistemi kombëtar i Metrologjisë përbëhet nga:

- i. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë;
- ii. Laboratorët e autorizuar si mbajtës të etaloneve kombëtare dhe sekondare;
- iii. Personat juridikë privatë të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për të kryer shërbimet e parashikuara në këtë ligj;
- iv. Personat juridikë të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë për të kryer verifikim periodik të instrumenteve në metrologjinë ligjore, sipas dispozitave të këtij ligji;
- v. Personat juridikë dhe fizikë të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë për të kryer riparim të instrumenteve matëse.

Misioni i DPM-së është:

- Mbrojtja e konsumatorëve dhe shtetit nga rezultatet e pasakta të matjeve;
- Zhvillimi i sistemit kombëtar të metrologjisë në përputhje me kërkesat ndërkombëtare dhe nevojat kombëtare;
- Njohja ndërkombëtare e rezultateve të matjeve kombëtare dhe të etaloneve kombëtare të matjeve;
- Lëvizja e lirë të instrumentave matëse ligjërish të kontrolluara, nëse këto instrumenta kanë shenjën e miratimit të tipit dhe verifikimit fillestar;
- Lëvizja e lirë të produkteve të parapaketuara, nëse ato kanë shenjën e konformitetit dhe harmonizimin e metodave për matjet dhe kontrollin metrologjik.

Organizimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë është person juridik, publik, i specializuar për metrologjinë, me qendër në Tiranë dhe e organizuar në Sektore Shërbimi në rrethe, në varësi të ministrit përgjegjës për Ekonominë, Kulturën dhe Inovacionin.
2. Juridiksioni i ushtrimit të veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë është i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë, ndërsa për Sektoret e Shërbimit, territori përcaktohet nga ministri përgjegjës për Ekonominë, Kulturën dhe Inovacionin, me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.
3. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili është nëpunës civil. Rekrutimi i nëpunësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në Ligj. Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" Struktura organike e DPM-së është 98, punonjës.
4. Organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
5. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ka katër drejtori, përkatësisht:
 - Drejtoria e Metrologjisë Shkencore dhe Industriale (DMSHI)
 - Drejtoria e Metrologjisë Ligjore (DML)
 - Drejtoria e Sigurimit të Cilësisë dhe Parapaketimeve (DSCP)
 - Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve (DBNJSH)

DPM aderon në:

OIML - Organizata Ndërkombëtare e Metrologjisë Ligjore - anëtare me të drejta të plota prej vitit 2001.

EURAMET - Shoqata Evropiane e Instituteve Kombëtare të Metrologjisë - anëtare me të drejta të plota prej vitit 2010.

WELMEC - Bashkëpunimi Evropian në Metrologjinë Ligjore - anëtare e asociuar prej vitit 2009.

IMEKO - Konfederata Ndërkombëtare e Matjeve - anëtare me të drejta të plota prej vitit 2000.

BIPM-CGPM - Byroja e Peshave dhe Masave - Shqipëria në vitin 2007, është anëtarësuar si Anëtare e Asociuar në Konferencën e Përgjithshme mbi Peshat dhe Masat.

Shërbimet kryesore metrologjike janë:

-Shërbime të kalibrimit që ofrohen nga laboratorët e Drejtorisë të Metrologjisë Shkencore dhe Industriale sipas kërkesave të subjekteve apo institucioneve shtetërore që përdorin instrumente matëse në fushat e masës, gjatësisë, forcës, presionit, elektrikut, termometrisë, lagështirës, volumeve dhe kimisë.

-Shërbime metrologjike të verifikimit të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar të ofruara nga Drejtoria e Metrologjisë Ligjore ku hyjnë: peshoret automobilistike, peshoret e tregimit me pakicë nga subjektet tregtare dhe ato farmaceutike, masat volumore, metrat e llojeve të ndryshme, depozitat dhe taksimetrat.

-Shërbime të autorizimit/monitorimit të subjekteve të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë që kryejnë verifikimin e instrumenteve matës që nuk kryhen nga Drejtoria e Metrologjisë Ligjore por autorizojnë subjekte të treta, ku hyjnë shërbimi i verifikimit të matësve të ujit, matësve elektrik, autoboteve, shërbime të riparimit të instrumenteve matës që përdorin

subjektet e ndryshme. Për të gjitha këto shërbime DPM zbaton tarifa të miratuara me udhëzimin përkatës.

Cdo vit planifikohen trajnime të specialistëve, me programe specifike brenda vendit, asistuar dhe nga ekspertë të huaj në kuadër të projekteve. Gjithashtu specialistët tanë marrin pjesë në komitete të ndryshme teknike që organizohen në vende të ndryshme sipas grafikut të EURAMET.

Për të siguruar gjurmueshmërinë e matjeve deri tek njësitë e Sistemit SI, etalonet e matjeve që përdoren nga laboratorët e DMSHI kalibrohen jashtë shtetit në Institute Metrologjike sipas procedurës së prokurimit të realizuar nga DPM. Në drejtim të sistemit të menaxhimit të cilësisë është bërë mirëmbajtja dhe zgjerimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë në DMSHI dhe DPM në përputhje me standardin SSH EN ISO/IEC 17025:2017 ku aktualisht janë të njohura tre fusha, perkatesisht volume, mase dhe presion.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË

MIRATOHET

MINISTËR I MINISTRISË SË EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT

BLENDI GONXHJA

PLANI I PUNËS I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË METROLOGJISË PËR VITIN 2024

OBJEKTIVAT	MASAT DHE VEPRIMET E MARRA	AFATI	TREGUESIT MONITORUES/STATUSI I REALIZIMIT	NJËSIA PËRGJEGJËSE
Përmirësimi i pakctës ligjore në fushën e metrologjisë për përafrimin me legjislacionin Evropian Draft VKM për mundësinë e kryerjes së procesit të kalibrimit të etaloneve	Kryerja e procesit të kalibrimit të etaloneve të DPM-së, jashtë procedurave të tenderimit të parashikuara në ligjin për prokurimet publike	Gjatë vitit	Krijimi i mundësive për të realizuar procesin e kalibrimit të etaloneve të DPM-së	MEKI, DPM, Grup pune

<p>jashitë procedurave të tenderimit.</p> <p>Miratimi i akteve ligjore sekondare</p>	<p>Përfundimi i akteve nënligjore të ligjit nr.126, datë 15.10.2020 "Për Metrologjinë" përkatësisht urdhër i ministrit për miratim tipi, udhëzimi i tarifave, urdhër ministri për shenjë dalluese, rregullore e brendshme e DPM,</p>	<p>8/mujori i parë 2024</p>	<p>Akte të miratuara</p>	<p>MEKI, DPM, DBNJSH</p>
<p>Përmirësimi i treguesve teknik dhe financiar</p>	<p>Kallibrime dhe verifikime të instrumenteve matës tëfushave që mbulon DMSHI dhe DML</p> <p>Mbrojtja e konsumatorit dhe shtetit nga rezultatet e pasakta të matjeve të instrumenteve matëse, nëpërmjet realizimit të shërbimit të verifikimit të instrumenteve matës ligjorisht të kontrolluar. Realizimi i kalibrimeve tëinstrumentave matës të fushave përkatëse që mbulon DMSHI sipas kërkesave të subjekteve të jashtëm dhe të brendshëm</p>	<p>Gjatë vitit</p> <p>Gjatë gjithë vitit</p> <p>Gjatë vitit sipas kërkesave të subjekteve të jashtëm dhe të brendshëm</p>	<p>Ndjekja sistematike cdo muaj</p> <p>Realizimi i 41300 shërbimeve të verifikimit dhe kalibrimit dhe të ardhurave në masën e 72 milion leke (pa TVSH).</p>	<p>DMSHI, DML</p> <p>DML dhe Sektorët e saj të Shërbimit në Tiranë, Korçë, Fier dhe Lezhë</p> <p>Përgjegjësit e Sektorëve dhe specialistët</p>
<p>Autorizimi i subjekteve juridikë, ose/dhe fizikë për kryerjen e veprimtarive në Metrologjinë Ligjore, konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> i. verifikim i instrumenteve matëse ligjorisht të kontrolluara; ii. ekspertizë metrologjike; 	<p>Sipas kërkesave të subjekteve, përgjatë vitit</p>	<p>Trajtimi i kërkesave të subjekteve për autorizim, shqyrtim i dokumentacionit përkatës, kryerja e vizitave vlerësuese dhe nxjerrja e vendimeve administrative për dhënie autorizimi</p>	<p>DML, grupi i punës (DML, DMSHI, DBNJ&SH, DSCP) dhe DP</p>	

	<p>iii. riparim, verifikim i përkohshëm dhe vulosje.</p> <p>Kryerja e vizitave monitoruese 1-vjeçare në Subjektet e autorizuar nga DPM-ja.</p> <p>Mbyllja e bilancit për vitin 2023</p>	<p>Gjatë vitit</p> <p>Brenda 3 mujorit të parëtë vitit</p>	<p>Kryerja e 14 vizitave monitoruese, dhe ndjekja e procedurave përkatëse, deri në lëshimin e raportit të vizitës monitoruese për subjektin.</p> <p>Dorëzimi i bilancit</p>	<p>Grupi i punës i ngritur me urdhër të DP, me përfaqësues nga DML, DMSHI, DBNJ&SH, DSCP</p> <p>DBNJSH</p>
<p>Kalimi me sukses i vlerësimit (peer review) të SM për përbushjen e kërkesave të ISO IEC 17025:2017 dhe të CIPM MRA (Projekti no. 1605) dhe marja e besueshmërisë nga EURAMET pas vlerësimit dhe raportimit të performancës 5 vjeçare pranë Komitetit Teknik për Cilësinë të EURAMET.</p>	<p>Organizimi dhe kryerja e vizitës vlerësuese të Sistemit të Menaxhimit dhe të Laboratorit të Presionit që kanë CMC të deklaruara në BIPM KCDB. Bashkëpunim me DMSHI për organizimin dhe bashkërendimin e vizitave vlerësuese (peer review) nga ekspertë Evropian për 3 fushat që kanë CMC të deklaruara në BIPM KCDB, në kuadër të rivlerësimit çdo 5 vjet nga ana e EURAMET në përputhje me rregullat dhe standartet e organizatës.</p> <p>Hartimi i raportit të performancës dhe rivlerësimit të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë së DPM për periudhën 2019-2024 dhe hartimi i raportit vjetor për vitin 2023 në përputhje me kërkesat e EURAMET dhe dërgimi në afat pranë Komitetit Teknik për Cilësinë.</p>	<p>Janar, shkurt 2024</p> <p>Tremujori i parë 2024</p>	<p>Raportet e vlerësimit sipas formatit të EURAMET. G-TCQ-TMP-002 Raport final i vizitës vlerësuese në terren</p> <p>Raporti i rivlerësimit të SMC dërgohet në TCQ deri më 16 shkurt 2024</p>	<p>Menaxheri i Cilësisë/Pergjegjesja e Sektorit të SSC në bashkëpunim me DMSHI</p> <p>Menaxheri i Cilësisë</p>

<p>Mirëmbajtja e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë sipas ISO 17025 dhe CIPM MRA, Zgjerimi i SMC në laboratorë/fusha të tjera, në përputhje me prioritetet/planin e veprimit të Drejtorisë së Metrologjisë Shkencore dhe Industriale</p>	<p>Përgatitja e materialit prezantues për mbledhjen vjetore të Komitetit Teknik për Cilësisë dhe prezantimi i tij në mbledhjen plenare të këtij komiteti, marrja e votëbesimit të anëtarëve në përputhje me rregullat e EURAMET dhe CIPM MRA.</p>	<p>Mars 2024</p>	<p>Marrja e besueshmërisë së EURAMET mirëfunksionimin e SM të DPM sipas ISO17025:2017 dhe ruajtja e CMC-ve në databazën BIPM KCDB. Materialet publikohen në faqen zyrtare të EURAMET</p>	<p>Menaxheri i Cilësisë</p>
<p>Rishikimi i Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë sipas standardit ISO/IEC 17025:2017 dhe (CIPM MRA), bazuar në nevojat e evidentuara gjatë vitit 2023,</p>	<p>Rishikimi i dokumentacionit të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë sipas standardit ISO/IEC 17025:2017 dhe (CIPM MRA), bazuar në nevojat e evidentuara gjatë vitit 2023,</p>	<p>Gjatë vitit</p>	<p>Miratimi i Dokumentacionit të rishikuar nga Drejtori i Përgjithshëm/Menaxheri teknik (sipas rasti) dhe vënia në dispozicion të strukturave përkatëse dhe në Intranet-in e DPM</p>	<p>DP, Menaxheri i Cilësisë,</p>
<p>Pjesëmarrje në ndërkrahime laboratorike apo PT në kuadër të projekteve të EURAMET-it apo projekteve bilaterale, në fushën e gjatësisë, (EURAMET.L-S2.2.n01), etj.</p>	<p>Pjesëmarrje në ndërkrahime laboratorike apo PT në kuadër të projekteve të EURAMET-it apo projekteve bilaterale, në fushën e gjatësisë, (EURAMET.L-S2.2.n01), etj.</p>	<p>Gjatë vitit, organizime të EURAMET-it, marrëdhënieve dypalëshe</p>	<p>Rezultatet e ndërkrahimeve apo PT nga organizatorët.</p>	<p>Cdo sektor dhe specialist i DMSHI</p>
<p>Kordinimi i vizitave vlerësuese për vlerësimin e kompetencës teknike tëlaboratorëve/fushave të DMSHI që janë planifikuar tëakreditohen gjatë vitit 2024, përkatesisht elektrik, temperaturë, lagështi, gjatësi nëpërputhje me planin vjetor të DMSHI miratuar nga Drejtori Përgjithshëm i DPM</p>	<p>Kordinimi i vizitave vlerësuese për vlerësimin e kompetencës teknike tëlaboratorëve/fushave të DMSHI që janë planifikuar tëakreditohen gjatë vitit 2024, përkatesisht elektrik, temperaturë, lagështi, gjatësi nëpërputhje me planin vjetor të DMSHI miratuar nga Drejtori Përgjithshëm i DPM</p>	<p>Gjatë vitit 2024</p>	<p>Përgatitja e dosjes për aplikim dhe dorëzimi pranë trupës akredituese që do të përzgjidhet nga DPM, Raporti i vlerësimit nga trupa akredituese</p>	<p>Sektori i Sigurimit të Cilësisë në bashkëpunim me DMSHI</p>
<p>Kryerja e auditimeve të brendëshme të SMC sipas programit vjetor të auditimeve në</p>	<p>Kryerja e auditimeve të brendëshme të SMC sipas programit vjetor të auditimeve në</p>	<p>Gjatë gjithë vitit, referuar</p>	<p>Realizimi i auditimeve dhe dokumentimi i gjetjeve/fo-</p>	

<p>bashkëpunim me ekipet audituese mbështetur në procedurën operacionale DPM-PO-06 në versionin e saj më të fundit</p>	<p>programit të vjetor auditimeve të brendëshme 2024</p>	<p>konformiteteve dhe veprimeve korigjuese.</p>	<p>Sektori i Sigurimit të Cilësisë në bashkëpunim me DMSHI</p>
<p>Hartimi i procedurave të kalibrimit dhe verifikimit për instrumentet matës referuar kapaciteteve teknike dhe shërbimeve që kryejnë laboratorët kalibrues të DPM dhe Sektorët e Shërbimit.</p>	<p>Gjatë vitit</p>	<p>Miratimi i procedurave teknike të kalibrimit dhe verifikimit</p>	<p>Cdo drejtori për fushën që mbulon</p>
<p>Implementimi i kërkesave të standardit ISO/IEC 17020: 2012 “Vlerësimi konformitetit Kërkesat për funksionimin e llojeve të ndryshme të organeve që kryejnë inspektim” në sektorët e shërbimit të Drejtorisë së Metrologjisë Ligjore</p>	<p>Gjatë vitit sipas programit të vjetor të trainimeve</p>	<p>Dokumentacioni i rishikuar miratohet nga strukturat eprore dhe vëhet në zbatim nga strukturat përkatëse të metrologjisë ligjore</p>	<p>Sektori i Sigurimit të Cilësisë</p>
<p>Organizimi i trainimeve të brendëshme të personelit të metrologjisë ligjore (sektorëve të shërbimit) për vënien në zbatim të standardit ISO 17020 dhe dokumentacionit të SMC për metrologjinë ligjore</p>	<p>Gjatë vitit</p>	<p>Dokumentimi i materialeve trajnuese dhe mirëmbajtja e regjistrimeve sipas kërkesave të SMC</p>	<p>DSCP në bashkëpunim me DML</p>
<p>Planifikimi, organizimi dhe kryerja e auditimeve të brendëshme për të verifikuar</p>	<p>Gjatë vitit</p>	<p>Dokumentimi i të gjithë procesit të auditimit</p>	<p>Sektori i Sigurimit të Cilësisë në bashkëpunim me DML dhe DMSHI</p>

	plotësimin e kërkesave të standardit ISO/IEC 17020:2012	Gjatë vitit	Dhënia e certifikatave të kalibrimit	sipas specifikave të fushës objekt auditimi
<p>Rritja e kapaciteteve teknike dhe përmirësimi i kushteve të punës</p>	<p>Realizimi i kalibrimit të instrumenteve matës të Sektoreve të Shërbimeve të DML-së dhe sektorit të produkteve të parapaketuara</p> <p>Hartimi i specifikimeve teknike për investimet e planifikuara dhe ndjekja e procedurave të tenderimit</p> <p>Krijimi i Regjistrit Elektronik të Metrologjisë dhe Kalibrimit, referuar akteve ligjore në fuqi.</p>	<p>Gjatë vitit</p> <p>Gjatë vitit</p> <p>Në vazhdimësi, përgjatë vitit</p>	<p>Dhënia e certifikatave të kalibrimit</p> <p>Kryerja e tenderave dhe marrja në dorëzim e pajisjeve</p> <p>Mbyllja e procesit të hartimit të specifikimeve teknike dhe nxjerrjen e fondit limit për Regjistrin Elektronik të Metrologjisë.</p>	<p>DMSHI në bashkëpunim me DML</p> <p>DPM dhe DBNJSH</p> <p>MEKI, AKSHI, DPM, DML,</p>
<p>Rritja e kapaciteteve menaxhuese e profesionale të administratës</p>	<p>Ngritja e nivelit tekniko-profesional të punonjësve të DPM</p> <p>Pjesëmarrje në workshope, seminare dhe trajnime të organizuara me mbështetjen e buxhetit të shtetit, projekteve në zbatim</p> <p>Pjesëmarrje në takimet vjetore dhe takimet e Komiteteve Teknike të Organizatave Evropiane dhe Ndërkombëtare të metrologjisë: EURAMET WELMEC, IMEKO, BIPM</p>	<p>Sipas programeve të vecanta</p> <p>Gjatë vitit, sipas planifikimit</p>	<p>Organizimi i seminareve dhe pjesëmarrja në trajnime, pajisja me certifikatë</p> <p>Realizimi i pjesëmarrjes në aktivitetet, raporti përkatës</p>	<p>Specialistë të sektorëve sipas fushave të aktivitetit</p> <p>Punonjësit e DPM sipas fushave</p>

	<p>Seminare, kurse trajnimi në punonjësit e Sektorëve të Shërbimit</p> <p>Promovime të aktiviteteve të DPM Aktivitete promovuese dhe sensibilizuese për metrologjinë (dita botërore e metrologjisë 20 Maj, botime informuese si: fletë palosje, botime, postera, takime informative me palët e interesuara, etj)</p> <p>Botimi i gazetës periodike Metrologjia,</p>	<p>Gjatë vitit</p> <p>Sipas një programi të vecantë</p> <p>Shkurt, shtator 2024</p>	<p>Sipas programeve të vecanta</p> <p>Realizimi i aktiviteteve</p> <p>Hartim i artikujve dhe dorëzimi te organizatorët e gazetës</p>	<p>DML dhe sektorët e shërbimeve nr.1, 2, 3, 4</p> <p>Cdo specialist dhe sektor</p> <p>DBNJSH dhe personat e ngarkuar</p>
<p>Forcimi i bashkëpunimit me strukturat ndërkombëtare dhe europiane të metrologjisë, dhe homologët</p>	<p>Pjesëmarrje aktive në aktivitetet e Focus Grup të EURAMET për vendet e Evropës Juglindore dhe në Asambleenë e Përgjithshme të EURAMET</p> <p>Ndjekja e aktiviteteve të Projektit - Programi Global i Cilësisë dhe Standardeve (GQSP) Albania i fokusuar ne "Forcimi i cilësisë dhe kapacitetit të pajtueshmërisë për zinxhirët e zgjedhur të vlerës për bimët medicinale, aromatike dhe fruta perimct"</p> <p>Ndjekja e aktiviteteve të Projektit "EU4 Biznesi: Nxitja e tregut të përbashkët rajonal përmes infrastrukturës cilësore dhe e-commerce" e fokusuar në pajisjet elektrike, makineritë dhe materialet e ndërtimit</p>	<p>Sipas planifikimit</p> <p>Sipas planit të aktiviteteve të projektit</p> <p>Sipas planit të aktiviteteve të projektit</p>	<p>Raportimet e realizimit të objektivave</p> <p>Raportet e takimeve</p> <p>Raportet e takimeve</p>	<p>DPM, drejtoritë përkatëse</p> <p>DPM, drejtoritë përkatëse</p> <p>DPM, drejtoritë përkatëse</p>

Bashkëpunimi me ministrinë dhe institucionet e tjera qëndrore	Trajtimi i çështjeve për nënshkrim apo rishikim të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institutet homologe të rajonit (Kosovë, Mal i Zi, Maqedoni,) dhe më gjerë.	Gjatë vitit	Nënshkrim i marrëveshjeve	DPM, drejtorinë përkatëse
	Bashkëpunim me ministrinë përkatëse në kuadër të implementimit të direktivave evropiane me të cilat trajtojnë edhe probleme të metrologjisë.	Sipas kërkesës të ministrive	Pjesëmarrje në grupet e punës	DPM
	Zgjerimi i bashkëpunimit dhe ndjekja e zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me strukturat e infrastrukturës të cilësisë, me universitetet dhe institucionet kërkimore shkencore si dhe komunitetin e biznesit	Gjatë vitit	Zbatimi i pikave të marrëveshjes	DPM

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Petrit Rama



Shënim:

Shkurtime të përdorura në këtë dokument kanë kuptimet e mëposhtme.
 MEKI - Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.
 DP - Drejtor i Përgjithshëm.
 DPM - Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë
 DML - Drejtoria e Metrologjisë Ligjore.
 DMSHI - Drejtoria e Metrologjisë Shkencore dhe Industriale.
 DSCP - Drejtoria e Sigurimit të Cilësisë dhe Parapaketimeve.
 DBNJ&SH - Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve.

AKSHI - Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.
CIPM MRA - Marrëveshja e Njohjes së Ndërsjellë të Komitetit Ndërkombëtar për Masat dhe Peshat (Mutual Recognition Arrangement of the International Committee for Weights and Measures).
BIPM KCDB - Database i Krahasimeve Kyçe në Byronë Ndërkombëtare të Masave dhe Peshave (Key Comparison Database of International Bureau of Weights and Measures).
CMC - Aftësitë Matëse Kalibruese (Calibration and Measurement Capability).